



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.
Nr./No./Br. 01-2606/21
Data/Date/Daturo 26-10-2021
KRYETARË-ORINJË-PRËSHITËR

Ndërmarrja Publike Qendrore
Posta e Kosovës Sh.A.

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, e në mbështetje të dispozitave të nenit 1, 2, 17, 18, 19 dhe 23 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Ligji nr. 06/L-011, nenit 1, 2, 5, 13, 24 dhe nenit 28 të Ligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, në zbatim të dispozitave të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, pikës 7/faqe 26, pikës 7.2/ faqe 26, pikës 7.4/ faqe 27 dhe pikës 7.7/ faqe 29, në zbatim të dispozitave të Rregullores për përgjegjësi disiplinore dhe materiale të PK Sh.A., Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Postës së Kosovës, në mbledhjen nr.17/2021 të mbajtur më datë 25/10/2021, nxjerr:

RREGULLORE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT
DHE NEPOTIZMIT NË PK SH.A.

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i procedurave për zbatimin e legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit dhe nepotizmit në Postën e Kosovës.

Kjo Rregullore ka për qëllim sigurimin që zyrtarët publik, të cilët mbajnë funksione menaxheriale dhe vendimmarrëse, të shmangin dhe mos të jenë në konflikt të interesit dhe nepotizmit.

Me Rregullore janë përcaktuar rregullat për sinjalizimin, procedurën e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesve, si dhe detyrimet e PK Sh.A. lidhur me pranimin dhe trajtimin e sinjalizimit për konflikt të interesit.

Neni 2
Konflikti i Interesit dhe Nepotizmit

1. Konflikti i mundshëm apo ekzistues i interesit ndodh në secilin rast kur një punonjës është në pozitë të ndikojë në një vendim, apo janë dy familjarë në një departament apo drejtori që mund të ndikojnë në favore, në fitim personal/financiar të vet punonjësit, apo ndonjë anëtar i të afërt të familjes (p.sh. bashkëshortit/es, fëmijëve, prindërve, motrave /vëllezërve), si dhe konflikte të interesit të mundshme në bazë të legjislacionit pozitiv.

2. Punonjësi obligohet ta njoftojë eprorin/mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë për çfarëdo konflikt të mundshëm të interesit që mund të ketë drejtpërdrejtë apo tërthorazi, ashtu që PK Sh.A. të mund ta vlerësojë dhe ta parandalojë këtë konflikt të interesit.
3. Mos deklarimi, apo fshehja e konfliktit të interesit nga punonjësi përbën shkelje të rëndë disiplinore.
4. Konflikti i interesit të zyrtarëve të Postës së Kosovës nënkupton ndeshjen, apo kundërshtimin e interesit privat me atë zyrtar, në raport me përfitimet financiare, favorizimet apo forma tjera të përfitimit me anëtarët e ngushtë të familjes dhe definicionit si në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
5. Nuk lejohet që zyrtarët në pozita menaxhuese dhe punonjësit e Postës së Kosovës që janë në lidhje familjare dhe të gjinisë të jenë në zinxhirin e hierarkisë mbikëqyrje, vlerësim, raportim.
6. Zyrtarët e Postës së Kosovës duhet që detyrimisht të paraqesin konfliktin e interesit gjatë detyrave të tyre, të deklarohen me shkrim sipas formës standarde.

Neni 3 Nepotizmi/Familjarizimi

1. Zyrtarët e Postës së Kosovës duhet të deklarohen me shkrim sipas formës standarde që është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje për anëtarët e familjeve dhe lidhjeve të gjakut dhe krushqisë/gjinisë.
2. Zyrtarët e Postës së Kosovës duhet të vet deklarohen nëse pozita e tyre dhe pozita e anëtarëve të familjes dhe anëtarëve në lidhje gjaku dhe krushqisë/gjinisë bien ndesh me ushtrimin e detyrave të punës.
3. Zyrtarët e Postës së Kosovës nuk mund t'i mbajnë të fshehura lidhjet familjare dhe të gjinisë me asnjë punonjës të Postës së Kosovës, qoftë dhe jashtë njësive/ departamenteve dhe drejtorive të punës së tyre.

Neni 4 Deklarimi i konfliktit të interesit dhe lidhjeve familjare

1. Aneksi I i kësaj Rregulloreje përbën obligim që secili punonjës i Postës së Kosovës, pavarësisht pozitës, duhet ta plotësojë me kërkesat si në formën e deklaratës.
2. Refuzimi apo deklarimi i pasaktë apo fshehja e lidhjeve familjare do të afektojë shkelje të rëndë disiplinore.

Neni 5

Mënjanimi (shmangia) i konfliktit të internist dhe familjarizimit

1. Menaxhmenti i Postës së Kosovës, pas shqyrtimit të të gjitha rasteve të konfirmuara që ndodhen në konflikt të interesit për shkak të lidhjeve familjare, do të ndërmerr veprime ligjore për rregullimin e pozitive brenda strukturës organizative ndaj zyrtarëve në Menaxhment dhe punonjësit që janë në raport të hierarkisë mbikëqyrje/raportim.
2. Kryeshefi Ekzekutiv do të caktojë një zyrtar me përgjegjësi të delegimit brenda RNJ-së që të përcjell në vazhdimësi zinxhirin e hierarkisë së zyrtarëve dhe punonjësve për të mënjanuar/shmangur konfliktin e interesit dhe nepotizmin gjatë ushtrimit të detyrave të punës.
3. Zyrtari i deleguar për këtë detyrë duhet të raportojë te Kryeshefi Ekzekutiv së paku njëherë në tre muaj për gjendjen aktuale të konfliktit të interesit dhe nepotizmit, nëse ka pasur ndonjë lëvizje apo ndryshim në zinxhirin e hierarkisë mbikëqyrje, vlerësim, raportim, në kundërshtim me ligjin dhe këtë Rregullore.
4. Kryeshefi Ekzekutiv, me kërkesën e Bordit, por edhe së paku dy herë në vit (çdo gjashtë [6] muaj) duhet të raportojë te Bordi i Drejtorëve për gjendjen e konfliktit të interesit dhe nepotizmin në Postën e Kosovës.

Neni 6

Forma e Deklaratës së Konfliktit të Interesit dhe Nepotizmit

1. Forma e Deklaratës për konflikt të interesit dhe nepotizmit është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje si ANEKSI I.

Neni 7

Obligimet e Ndërmarrjes

Obligimet e ndërmarrjes publike qendrore Posta e Kosovës Sh.A. në zbatim të dispozitave ligjore të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr. 06/L-011 dhe të Ligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve janë:

- a. Caktimi i një zyrtari përgjegjës (brenda ndërmarrjes me detyrë shtesë) për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimit për konflikt interesi;
- b. Deklarimi lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë zyrtarët në pozita udhëheqëse brenda ndërmarrjes;
- c. Identifikimi, adresimi apo eliminimi i konflikteve të interesit brenda ndërmarrjes PK Sh.A.;
- d. Raportimi i rregullt së paku çdo 6 muaj tek Aksionari mbi numrin dhe natyrën e rasteve të konfliktit të interesit dhe nepotizmit në ndërmarrje.

Neni 8
Plotësim/Ndryshimi

Kjo Rregullore mund të ndryshohet/plotësohet sipas nevojës dhe konform ndryshimeve ligjore në Republikën e Kosovës në interes të Postës së Kosovës, me kërkesën e Bordit apo Menaxhmentit.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Përkohshëm Drejtorëve të Postës së Kosovës Sh.A.

Safija Beseni


Kryesuese e Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve
NPQ Posta e Kosovës Sh.A.



ANEKS 1.

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Rregullores së brendshme për parandalimin e konfliktit të interesit dhe nepotizmit në PK Sh.A. lidhur me Deklarimin rast për rast i interesave private të zyrtarit, deklaroj si në vijim:

DEKLARATË E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Deklaruesi Z/Znj.

Pozita deklaruese

Punëdhënësi

Në cilësinë e _____, me përgjegjësi të plotë morale dhe penale deklaroj se nuk kam konflikt interesi sipas Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Rregullores së brendshme për parandalimin e konfliktit të interesit dhe nepotizmit në PK Sh.A. që do të mund të vente në dyshim kryerjen e detyrës si _____.

Gjatë gjithë ushtrimit të detyrës sime, në rast të shfaqjes së ndonjë situatë eventuale të konfliktit të interesit, zotohem se do ta deklaroj menjëherë para udhëheqësit të drejtpërdrejtë dhe do t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të evitimit të konfliktit të mundshëm të interesit sipas legjislacionit në fuqi.

Nënshkrimi:

Data:
